



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

---

**VENDIM**

Nr 6 , Datë 03.11. 2011

**Për**

**Miratimin e projekt- idesë të objektit "Diga e Murdharit-1" Tiranë**

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshillit Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 28. 10. 2011, mori në rishqyrtim projekt-idenë e objektit "Diga Murdharit-1" Tiranë, i hartuar nga "HIDRO KONSULT KONSTUKSION", dhe dërguar në KKDM me shkresën nr. 3993/20 prot, datë 10.05.2010, nga Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës. Projekt-ideja e objektit "Diga Murdhari-1", Tiranë u paraqit nga "HIDRO KONSULT KONSTUKSION".

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha mbasi diskutoi për të:

**Vendosi**

Të argumentohen dhe të plotësohen nga grupi i projektimit vëretjet e mëposhtme:

1. Qëllimi dhe argumentimi ekonomik i ndërtimit të digës, (neni 8 i "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave") Ndikimi i saj në përmirësimin e parametrave energjitike dhe ekonomike të hidrocentraleve të kaskadës.

2. Diga të trajtohet, jo si objekt i klasit të III-të por si objekt i klasit të I-rë duke marrë parasysh zonën e mbipopulluar në luginën e Erzenit, poshtë objektit.
3. Të parashikohet shkarkues fundor, që në rast nevoje, të bëhet ulja e nivelit të ujit në rezervuar, (në mbështetje të pikës 2).
4. Të paraqitet studimi për qëndrueshmërinë e shpateve të kupës së liqenit të ardhshëm.
5. Projekt-ideja mbasi të plotësohet me vëretjet e mësipërme të riparaqitet për shqyrtim në Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

**Prof. FARUDIN HOXHA**

**KRYETAR**

